

UDHËZIM
Nr.1, datë 13.1.2004

PËR MËNYRËN E NGRITJES DHE KRIJIMIT TË INSPEKTORATEVE TË ULËTA

Në mbështetje të nenit 17 e 23 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve finaciare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik",

UDHËZOJ:

1. Inspektoratet e ulëta të krijohen sipas mënyrës së parashikuar në nenin 18 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003.

2. Titullari i institucionit të administratës publike në nivelin qendror apo vendor, institucionet e pavarura, organet e pushtetit vendor, prefekti i qarkut, bankat dhe institucionet financiare shoqërore, korporatat e shndërruara në shoqëri ose jo anonime, ku pjesëmarrja e shtetit është mbi 50%, për të ngritur dhe krijuar inspektoratet e ulëta duhet të mbajnë parasysh këto kritere:

- Institucionet qendrore duhet të krijojnë inspektoratet e ulëta me një numër tek, në mënyrë që vendimmarrja të jetë e shpejtë dhe efektive.

- Inspektoratet e ulëta duhet të kenë një numër anëtarësh në raport me numrin e subjekteve që do të deklarojnë pasurinë dhe detyrimet financiare, duke krijuar mundësi menaxhimi dhe vetëveprimi.

3. Në rastet kur pranë institucioneve të varësisë së institucioneve të administratës qendrore, degëve, filialeve apo njësive të tyre janë ngritur inspektoratet e ulëta dhe numri i tyre është më i lartë se kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim, atëherë titullari i institucionit qendror duhet të rishikojë aktin e ngritjes së këtij inspektorati, në përputhje me këtë udhëzim, brenda 14 ditëve nga botimi i këtij udhëzimi në Fletoren Zyrtare.

4. Në përputhje me nenin 18 të ligjit, këshillat e qarqeve të marrin masa për ngritjen dhe funksionimin e inspektorateve të ulëta. Kryetarët e këshillave të qarqeve duhet të përcaktojnë edhe subjektet që do të deklarojnë pasurinë për bashkitë dhe komunat që kanë në juridiksion, në përputhje me nenin 3 pika 2 të ligjit dhe në bashkëpunim edhe me kryetarët e bashkive dhe të komunave.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi titullarët e institucioneve të administratës publike në nivel qendror apo vendor, të institucioneve të pavarura, organeve të pushtetit vendor, prefektët e qarkut, bankave dhe institucioneve financiare shoqërore, korporatave të shndërruara në shoqëri ose jo anonime, ku pjesëmarrja e shtetit është mbi 50%.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORE E PËRGJITHSHME
Fatmira Laska